



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 621/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2021, me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**KONSTATOHEN të tërhequra** e ankesat Anr.621/2021 dhe Anr.622/2021 të datës 16.10.2021, të parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Fushë Kosovë kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës.

#### **A r s y e t i m**

Me datën 16.10.2021, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Fushë Kosovë, ka paraqitur në PZAP ankesat Anr.621/2021 në të cilën pretendon se Jeton Zogjani nëpërmjet rrjetit social të tij Facebook ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë thirrje që të votohet kandidati për kryetar komune të Fushë Kosovës nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës duke publikuar numrin e subjektit dhe ankesën Anr.622/2021 në të cilën pretendohet se Isen Barbatovci ka shpërndarë në rrjete sociale një fletëvotim informues me të cilin veprimi subjekti politik LDK ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përkatësisht të nenit 36 të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, si dëshmi kësaj ankese i ka bashkangjitur fotografi të printuara të shkeljes së supozuar.

Ndërsa me datë 17.10.2021 subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka paraqitur pranë PZAP-së kërkesë me nr. Protokolli Anr.621/3 dhe 621/21 për tërheqje të ankesave Anr.621/2021 dhe Anr.622/2021 të datës 16.10.2021 për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-postim në rrjetin social Facebook.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesave, në kuptim të nenit 11 paragrafi 2 të Rregullës Nr.02/2015 të PZAP-it si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.621/2021 më datën 18.10.2021

**Kryesuese e Paneli**  
Kymete Kica



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij nuk lejohet ankesa.